

DAUEJA NË EPOKËN E ELEKTRONIKËS

Dr. Enver Hamid



Rrota e jetës rrotullohet e zhvillimet e saj nuk kanë të ndalur. Bota çdo ditë është në risi... Allahu i shpalli Ibrahimit, alejhi's salam: “*I mençuri që ka mendjen e kthjellët duhet të jetë syçelë ndaj kohës së tij*”¹. Për të qenë vigjilent ndaj kohës duhet ecur në hap me zhvillimet dhe teknologjinë e saj.

Bota rreth nesh përparon e zhvillohet, e kush nuk përparon, prapëson. Prej zhvillimeve bashkëkohore është edhe interneti, i cili disponon me karakteristika të shumta dhe

përdoruesve iu dhuron kënaqësinë e shprehjes së lirë të mendimit dhe ideve të tyre që në qarqe tjera nuk mund t'i shprehin dot. Element tjetër është edhe lidhja e shpejtë dhe sigurve që garanton interneti pa patur nevojë të qëndrosh në kabina telefonike apo të paguash shuma parash. Interneti konsiderohet mjete më i shpejt, më i lirë dhe me mundësitë më të mëdha për kontaktim të atyre që dëshirojnë. Mjafton që të shtypesh butonin e tastierës (enter) dhe kjo realizohet.

Për shkak të përdoruesve të shumtë mund të kesh qasje në çdo faqe, forum, grup, dhe për një çast të lidhesh me miliona njerëz. Brenda pak minutave falas mund të dërgosh shkresa në adresë të miliona njerëzve.

E tërë kjo shton përgjegjësinë e *duatëve* (misionarëve muslimanë) në kumtimin e fjalës së Allahut.

Nëse në të kaluarën muslimanët duheshin që të shpenzonin shumë e madje edhe të rrezikonin jetën e tyre vetëm e vetëm që mesazhin islam tua përcillnin njerëzve, madje duke bërë me mijëra kilometra, çfarë na pengon neve sot që falë ndihmës së Allahut e pastaj teknologjisë së internetit mund të arrijmë kudo, kurdo, tek çdokush, për tua prezantuar misionin tonë?

وَكَفَى اللَّهُ الْمُؤْمِنِينَ الْقِتَالَ

... *Dhe All-llahu ua largoi luftën besimtarëve...*” el-Ahzab, 25.

Çfarë do t'i thuash Zotit tënd nesër kur të pyet:

- Përse nuk e kumtove fenë e Zotit tënd?
- Çfarë të pengoi?
- Përse nuk e shfrytëzove Internetin, Skype-n, Facebook-un, Twitter-in?
- Përse nuk *e-mailoje* njerëzit?
- Përse nuk pate dhomë në Chatt që tu flasësh njerëzve për Islamin po ua dhatë këtë mundësi të tjerëve ta fyejnë Islamin e të hedhin dyshime për të dhe autenticitetin e tij?

¹ Këtë thënie e ka transmetuar Ebu Dherr-ri ndërsa e ka regjistruar Ibni Hibbani në Sahihun e tij. Albani në Silsiletu'd daifah ve'l meuduah, 7/91, e llogarit të dobët.

O ju hoxhallarë! Mos u arsyetoni, dhe mos thoni se nuk e njihni këtë teknikë ngase ajo nuk është më e vështirë se përdorimi i mobilit. Të duhet shumë pak kohë dhe mund për të përvetësuar mënyrën e përdorimit.



Ta dini o ju hoxhallarë se në kohën kur ju uleni në xhami² për t'i dhënë *ders* disa dhjetëra njerëzve, shumica të moshuar, vetëm në Egjipt në atë kohë ka mbi 12.000.000 përdorues të internetit, dhe atë ndërmjet moshave 12-35 vjeç.

A do të injoroni këto shifra dhe do t'i anashkaloni - të nderuar hoxhallarë – për tua kumtuar fenë e Zotit tuaj?

Interneti është bërë ndër qarqet informative më me ndikim ndaj mos ngurroni dhe mos humbni kohë...Ejani ta përhapim fenë e Allahut!

Allahu na dhëntë sukses për çdo punë që e do Ai dhe është kënaqësia e Tij në të!

Burimi: <http://www.hadielislam.com/arabic/index.php?pg=articles%2Farticle&id=30596>
Përshtati në shqip: Sedat ISLAMI
29-8-2010

² Autori nuk nënvlerëson rolin që ka xhamia porse mjaftimi vetëm me të si mjet i Daues është ajo që nuk pajton me të autori.